



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 5629 Prot.

Himarë, më 03.08.2026

MIRATOHET

Vangjel Tavo

KRYETAR

DETYRË PROJEKTIMI

STUDIM PROJEKTIM PËR OBJEKTIN:

"Ndërtimi i pedonales së Borshit".



Himarë, 2026

Përmbajtja:

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme
2. Objektivat dhe qëllimet kryesore të projektit
3. Kërkesat e projektit
4. Fazat e zbatimit
5. Standardet
6. Realizimi i projektit
7. Rekomandime për projektuesin
8. Paraqitja e vizatimeve
9. Raportimi dhe dorëzimi final
10. Investimi themelor
11. Sqarime të fundit

1. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

Bashkia Himarë kërkon të realizojë me fondin 17,122,463 lekë pa tvsh, (studim-projektim) për objektin: **"NDËRTIMI I PEDONALES SË BORSHIT"**, në Fshatin Borsh, Bashkia e Himarës. Vlera e investimit nga Autoriteti parashikohet të jetë 2,000,000,000 lekë (lekë me tvsh). Kjo vlerë është indikative dhe referenciale, e llogaritur mbi bazën e treguesve teknikë aktualë. Vlera finale e prokurimit do të përcaktohet pas procesit të miratimit të projektit dhe përputhjes me fondet limit të akorduara."

Referuar **Planit zhvillimor të pushtetit qendror dhe lokal në Republikën e Shqipërisë**, Autoriteti Kontraktor kërkon nga konsulenti të realizojë projektimin e infrastrukturës totale për objektin: **"NDËRTIMI I PEDONALES SË BORSHIT"**.

Zona e marrë në studim ndodhet në pjesën e territorit të Bashkisë Himarë përkatësisht në bregdetin e Borshit me një sipërfaqe rreth 20 ha e përcaktuar si zonë e re zhvillimore sipas planeve aftëgjatë të zhvillimit të ekonomisë në këtë zonë.

Disa nga sugjerimet për mënyrën e organizimit të preojektit të pedonales dhe elementët e saj përbërës:

PEDONALJA E BORSHIT

1. Shëtitorja

Tema

Lëvizshmëria & peizazhi bregdetar

Pikat e forta

- Brandimi i rivierës Shqiptare
- Mundësi realizimi me faza
- Tërheqje turistike
- Rivitalizimi i plazhit
- Lidhje vizuale me mjedisin natyror përreth

Përshkrimi i projektit

Shëtitorja do të ofrojë një itinerar të sigurt dhe të vazhdueshëm përgjatë vijës bregdetare, i strukturuar me programe dhe funksione të ndryshme përgjatë saj.

Ajo do të gjelbërohet me pemë për të krijuar hije dhe për të mundësuar qarkullim të rehatshëm për këmbësorët.

Projekti është konceptuar në mënyrë të tillë që të jetë i dukshëm dhe i perceptueshëm nga pjesa e sipërme e luginës, duke krijuar një lidhje të fortë vizuale midis zonës së banuar dhe bregdetit.

Mundësitë dhe roli i projektit

Mundësi programore:

- Atraksion i ri turistik (sektori publik)
- Aktivitet i ri bare dhe restorante (sektori privat)
- Strukturë hoteliere e shpërndarë (sektori privat)
- Dyqane të reja suveniresh (sektori privat)
- Produkte dhe aktivitete artizanale lokale (sektori privat)

Mundësi të tjera:

- Program i ri urban
- Zgjatje e aktiviteteve sezonale
- Përmirësim i vijës bregdetare
- Dinamikë ekonomike publike dhe private

Roli:

- Planifikim urban
- Hapësirë publike
- Aktivizim i zonës



2.FUSHAT SPORTIVE & KËND LOJËRASH

Tema

Aktivitetet shtesë & facilitet lokal

Pikat e forta

- Vendndodhje kyçe në vijën bregdetare
- Zgjatje e aktiviteteve sezonale

Përshkrimi i projektit

I vendosur në pjesën perëndimore të shëtitores, kjo hapësirë rekreative do të shënojë pikën e fillimit të saj.

Fushat sportive dhe këndi i lojërave për fëmijë krijojnë një hapësirë shumëfunktionale që i përgjigjet nevojave të ndryshme të komunitetit, duke promovuar një stil jete aktiv dhe të shëndetshëm.

Infrastruktura sportive do të jetë e larmishme, ndërsa zona e lojërave do të përshtatet për grupmosha të ndryshme, duke u mundësuar familjeve të shijojnë së bashku hapësirën bregdetare.

Mundësitë dhe roli i projektit

Mundësi programore:

- Facilitet i ri lokal

Mundësi të tjera:

- Program i ri urban
- Një facilitet cilësor për jetën aktuale dhe të ardhshme të zonës
- Zgjatje e aktiviteteve sezonale

Roli:

- Aktivizim i zonës



3. PISHINA NATYRALE

Lloj

Rivitalizim bregdetar & peizazh

Pikat e forta

- Promovimi i Rivierës Shqiptare
- Krijimi i një atraksioni të vogël me lidhje me detin
- Përmirësimi i peizazhit dhe hapësirës publike

Përshkrimi i Projektit

Plazhi i Borshit ka veçorinë që ngushtohet shumë në pjesën lindore. Për të kompensuar këtë kufizim hapësinor, mund të ndërtohet një pishinë natyrale. Ajo do të ofrojë një hapësirë rekreative të jashtëzakonshme, e cila integrohet në mënyrë harmonike me mjedisin bregdetar. Kjo pishinë natyrale përgjatë shëtitores do të jetë një vend unik dhe miqësor ndaj mjedisit, që kontribuon në atraktivitetin turistik të rajonit duke ruajtur bukurinë natyrore të bregdetit.

Mundësitë dhe roli i projektit

Mundësi programore:


- Atraksion turistik i ri (sektori publik)
- Aktivitetet ujorë për shkollë (sektori privat)

Mundësi të tjera:

- Program i ri peizazhi

Roli:

- Aktivitet



4.URË

Lloj

Lëvizshmëri & pamje detare

Pikat e forta

- Promovimi i Rivierës Shqiptare
- Atraksion turistik
- Nënvizimi i peizazhit

Përshkrimi i projektit

Plazhi i Borshit ngushtohet ndjeshëm nga veriu në jug. Për të kompensuar këtë kufizim, propozohet vazhdimi dhe zgjerimi i shëtitorës drejt brendësisë, në zonat ku hapësira ngushtohet.

Në këtë mënyrë, shëtitorja bëhet e vazhdueshme dhe nuk ndërhyr në vijën bregdetare aty ku hapësira është e kufizuar.

Mundësitë dhe roli i projektit

Mundësi programore:


- Atraksion turistik i ri (sektori publik)

Mundësi të Tjera:

- Identitet grafik dhe branding + komunikim


Roli:

- Hapësirë publike




Për këtë zonë zhvillimore propozohen profila tip si më poshtë:

Janë propozuar 2 profile tip rruge si më poshtë (në përmasa do përshtaten nga projektuesi gjatë fazës së projektimit në bashkëpunim dhe konsultim me drejtorinë e planifikimit dhe zhvillimit të territorit të Bashkisë Himarë):




Prerja 1-1 (Pedonalja)

Projekti duhet të konsistojë në ndërtimin e paketës së shtresave rrugore, trotuarëve, pedonales së këmbësorëve ku të parashikohet vendosja e ndriçimit rrugor dhe rrjeti i linjave rezervë për internet, telefoninë, ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza, krijimin e korsisë së biçikletave, hartimin e sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale si dhe parashikimin e vendodhjes së pikave të koshave për grumbullimin e mbetjeve urbane.



Profili zgjeruar 1 dhe dimensionet (orientuese)

“Profili i zgjeruar i shëtitorës paraqitet si zgjidhje konceptuale orientuese për segmentet me potencial rekreativ dhe hapësirë të mjaftueshme territoriale. Projektuesi duhet të studiojë dhe të përshtatë dimensionet përfundimtare të seksionit mbi bazën e rievimit topografik, gjendjes pronësore, dinamikës bregdetare, flukseve të lëvizjes dhe kushteve teknike të zonës. Në segmentet e zgjeruara të shëtitorës të studiohet integrimi i hapësirave rekreative, këndeve të lojërave, hapësirave për aktivitete publike dhe strukturave të tipit amfiteatër të hapur, duke garantuar vazhdimësinë e korridorit këmbësor, sigurinë e lëvizjes, aksesueshmërinë për PAK dhe integrimin me peizazhin bregdetar. Pozicionimi dhe zgjidhja teknike e këtyre elementeve duhet të argumentohen nga projektuesi në fazën e projekt-idesë dhe t’i nënshtrohen miratimit të Autoritetit Kontraktor.”



DREJTORIA E URBANISTIKËS - BASHKIA HIMARË: PROFILI I ZGJERUAR I SHËTITORËS SË BORSHIT - ZONA REKREATIVE

Profili zgjeruar 2 dhe dimensionet (orientuese)

Trajtimi arkitektonik, funksional dhe peizazhistik i shëtitorës

Profili tip i paraqitur për zonën rekreative të Shëtitorës së Borshit përbën një zgjidhje konceptuale orientuese për organizimin funksional të hapësirës bregdetare. Koncepti mbështetet në krijimin e një kalimi të harmonizuar nga zona e zhvilluar dhe strukturat akomoduese drejt vijës bregdetare, nëpërmjet organizimit të trotuarit për këmbësorë, aksit automobilistik, brezit të gjelbër, korsisë së biçikletave, shëtitorës së zgjeruar, hapësirave rekreative dhe brezit të plazhit.

Aksi automobilistik, me gjerësi orientuese 5.0–6.0 m, duhet të trajtohet si rrugë lokale me qarkullim dhe shpejtësi të kontrolluar. Projektuesi duhet të analizojë skemën e qarkullimit, lidhjet me rrjetin ekzistues, hyrje-daljet e strukturave përgjatë aksit dhe pikat e mundshme të konfliktit. Zgjidhjet për kryqëzimet, rrethrotullimet, elementet e ngadalësimit të trafikut dhe sinjalistikën duhet të argumentohen mbi bazën e studimit të lëvizshmërisë dhe flukseve të pritshme.

Ndërmjet rrugës automobilistike dhe hapësirave të lëvizjes së butë duhet të studiohet krijimi i një brezi të gjelbër me gjerësi orientuese rreth 2.0 m, i cili të funksionojë si element peizazhistik dhe brez tampon sigurie. Gjelbërimi duhet të realizohet me specie të përshtatshme

për klimën mesdhetare dhe kushtet e mjedisit bregdetar, rezistente ndaj thatësisë, kripësisë dhe erërave.

Përgjatë shëtitores duhet të parashikohet një korsi e dedikuar për biçikleta, e ndarë dhe e dallueshme nga lëvizja e këmbësorëve. Projektuesi duhet të përcaktojë dimensionimin përfundimtar dhe mënyrën e organizimit të kopsisë mbi bazën e standardeve teknike dhe flukseve të pritshme, duke trajtuar me kujdes pikat e konfliktit me hyrjet, zonat rekreative dhe korridoret e lëvizjes së këmbësorëve.

Në segmentet ku kushtet territoriale dhe teknike e lejojnë, duhet të studiohet krijimi i një shëtitoreje të zgjeruar dhe hapësirash publike shumëfunktionale, të destinuara për qëndrim, pushim, rekreacion dhe zhvillimin e aktiviteteve publike. Në këto zona mund të integrohen kënde lojërash për fëmijë, zona të hijëzuara, hapësira qëndrimi, ulëse të integruara në terren dhe hapësira për aktivitete kulturore, artistike ose evente në natyrë, përfshirë zgjidhje të tipit teatër i hapur apo amfiteatër.

Projektuesi duhet të garantojë në të gjithë gjatësinë e shëtitores një korridor të lirë, të vazhdueshëm dhe të pandërprerë për lëvizjen e këmbësorëve, duke shmangur pengesat nga mobilimi urban, shtyllat e ndriçimit, elementët e gjelbërimit dhe pajisjet rekreative. Projekti duhet të sigurojë aksesueshmëri të plotë për personat me aftësi të kufizuara.

Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajtimit arkitektonik të sipërfaqeve të pedonale, trotuareve, shesheve dhe zonave të qëndrimit. Për realizimin e shtrimeve duhet të parashikohet përdorimi prioritar i gurit natyror karakteristik të zonës, si material me vlera estetike, identitare dhe qëndrueshmëri të lartë.

Projektuesi duhet të studiojë dhe propozojë kompozime të ndryshme shtrimi dhe motive në formë mozaiku, të realizuara me gurë natyrorë të zonës, duke përdorur dimensione, tekstura dhe tonalitete të ndryshme të gurit. Motivet mund të frymëzohen nga karakteristikat e territorit, deti, valët, ulliri, relievi dhe elemente të tjera të identitetit lokal të Borshit dhe Himarës.

Mozaikët dhe ndryshimet në kompozimin e shtrimeve duhet të përdoren jo vetëm si element dekorativ, por edhe për diferencimin dhe orientimin funksional të hapësirës, duke evidentuar korridoret kryesore të lëvizjes, hyrjet drejt plazhit, sheshet, zonat rekreative dhe pikat e veçanta të interesit përgjatë shëtitores.

Materialet prej guri duhet të përzgjidhen mbi bazën e karakteristikave fiziko-mekanike dhe rezistencës ndaj konsumit, lagështisë, kripësisë dhe kushteve atmosferike të mjedisit bregdetar. Sipërfaqet duhet të jenë antirrëshqitëse dhe të përshtatshme për trafik të lartë këmbësor. Projektuesi duhet të përcaktojë tipologjinë dhe karakteristikat teknike të gurit, dimensionet, trashësinë, mënyrën e përpunimit, skemën e vendosjes, fugat, nënshtresën dhe detajet teknike të realizimit.

Në fazën e projekt-idesë duhet të paraqiten jo më pak se tre variante të trajtimit arkitektonik të shtrimeve dhe mozaikëve me gurë natyrorë të zonës, të shoqëruara me paletën e materialeve, motiveve dhe teksturave të propozuara. Zgjidhja përfundimtare do të përzgjidhet në konsultim dhe me miratimin e Autoritetit Kontraktor.

Zona në fjalë do rihvillohet në faza të ndryshme sipas planit të detajuar të zbatimit të punimeve, si rrjedhim projektuesi duhet ti jap zgjidhje aksesit të banorëve të zonës gjatë fazës së ndërtimit të infrastrukturës dhe të paraqesë mënyrat e aksesit dhe të qarkullimit në rrugë dhe lidhjet me rrjetin ekzistues rugor të zonës.

2. OBJEKTIVAT DHE QËLLIMET KRYESORE TË PROJEKTIT

Projekti i pedonale në Borsh synon të promovojë zhvillimin urban të qëndrueshëm, duke forcuar njëkohësisht cilësinë e jetesës dhe prosperitetin afatgjatë të zonës.

Një nga objektivat kryesore të projektit është përmirësimi i infrastrukturës lokale, me fokus të veçantë në rehabilitimin dhe përmirësimin e hapësirave dhe shërbimeve publike. Forcimi i këtyre elementeve thelbësore do të përmirësojë jetën e përditshme të banorëve dhe vizitorëve, duke siguruar një pikë tjetër të fortë për tërheqjen e turistëve në zonë, rrjedhimisht rritjen e të ardhurave nga turizmi për banoret e Borshit.

Një tjetër qëllim thelbësor është mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Borshit. Projekti përfshin iniciativa për ruajtjen e objekteve historike, mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e traditave lokale. Duke ruajtur këto vlera, Borshi mund të mbajë identitetin e tij unik dhe të vazhdojë të tërheqë vizitorë të interesuar për pasurinë e tij kulturore dhe bukurinë natyrore.

Projekti synon gjithashtu të nxisë zhvillimin ekonomik dhe të mbështesë sipërmarrjen lokale. Përmes investimeve të synuara në ndërmarrje të vogla, promovimit të praktikave të turizmit të qëndrueshëm dhe krijimit të vendeve të reja të punës, iniciativa synon të forcojë ekonominë vendore dhe të sigurojë rritje ekonomike gjithëpërfshirëse.

Angazhimi i komunitetit dhe përfshirja sociale janë shtylla themelore të projektit. Duke inkurajuar procese planifikimi pjesëmarrës, konsultime dhe partneritete me aktorët lokalë, projekti siguron që banorët të kenë një rol aktiv në formësimin e së ardhmes së Borshit. Kjo qasje bashkëpunuese promovon transparencën, ndërton besim dhe forcon ndjenjën e përkatësisë dhe pronësisë brenda komunitetit.

Në përfundim, objektivat gjithëpërfshirëse të projektit dëshmojnë një angazhim të fortë për zhvillimin e qëndrueshëm në Borsh. Duke përmirësuar infrastrukturën, duke ruajtur trashëgiminë kulturore dhe natyrore, duke nxitur rritjen ekonomike dhe duke vendosur në qendër pjesëmarrjen e komunitetit, projekti synon të krijojë një mjedis të qëndrueshëm, dinamik dhe gjithëpërfshirës për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

3. Kërkesat e projektit

Në këtë zonë, gjatë hartimit të projektit, duhet ti referoheni Planit të Përgjithshëm Vendor Për Zhvillim ose parashikimeve të mundshme lokale në planifikimin vendor.

a. Infrastruktura rrugore

Për trajtimin e rrjetit rrugor, gjërësisë së rrugëve dhe trotuarëve, duhet të mbahen parasysh standardet në fuqi (*Rregullorja e urbanistikës, KTP*).

Shtresat rrugore dhe të trotuarëve të trajtohen të tilla, që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të perspektivës. Shtrimi i trotuarëve dhe pedonales do të bëhet me **plaka guri**. Në pjesët e ndërprerjes së trotuarëve të parashikohet ndërtimi i panduseve të kalimit në nivel rrugë – trotuar për personat me aftësi të veçanta.

Gjatë hartimit të projektit të parashikohen vendosja e pikave të VGM në bashkëpunim me drejtoritë përkatëse të Bashkisë Himarë.

Materialet, që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve.

Gjatë hartimit të projektit projektuesi duhet të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë Himarë përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij dhe kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave, ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

Të përcaktohet lloji i rrugës sipas standartit EN 13201 Urbane, Rurale, Parësore, Dytësore, në mënyrë që të përcaktohet edhe lloji dhe intensiteti i ndriçimit.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi, përpara se të fillojë punën me projektimin duhet, që paraprakisht:

- a) Të bëjë relievin (azhornimin) e gjurmës së projektit; të jepet plani i piketimit (me pikat e forta etj);
- b) Të marrë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës;
- c) Projektuesi duhet të bëjë verifikim paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë, që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra, që nuk përputhen me gjendjen në terren;
- d) Të bëjë studimet përkatëse gjeologjike, hidrologjike etj. (sipas kërkesave të projektimit.

b. Skema e qarkullimit/lëvizjes

Projektuesi duhet të paraqesë mënyrat e aksesit dhe të qarkullimit në pedonale dhe lidhjet me rrjetin ekzistues rrugor të zonës.

Projektuesi duhet të hartojë dhe të paraqesë paraprakisht së bashku me skemën e rrjetit rrugor edhe analizën dhe skemën e qarkullimit/lëvizjes pas ndërtimit të pedonales. Kjo skemë duhet të jetë fletë e veçantë e projektit.

Projekti/skema duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë:

- i. Aksesin për të gjitha kategoritë e mjeteve, duke përfshirë rastet dhe mjetet e emergjencës (sidomos ato të zjarrit, shëndetit etj);
- ii. Parashikimin e mënyrës së lidhjes së rrugës me akset kryesore dhe blloqet e banimit kufitarë;
- iii. Aksesin e këmbësorëve duke i dhënë një përparësi të qartë në rezervimin e hapësirës së lëvizjes si dhe duke parashikuar lidhjen e lëvizshmërisë së tyre në zonë;
- iv. Aksesin e personave me aftësi të kufizuara;
- v. Shfrytëzimin efektiv të rrugës/pedonales;
- vi. Të gjithë elementët e mësipërm të ndërthuren në një projekt sinjalizimi rrugor duke siguruar një organizim të lëvizjes, që përmbush kërkesat si të banorëve ashtu dhe të aktiviteteve të mundshme ekonomike të zonës;
- vii. Plotësimin e elementëve të sigurisë rrugore duke trajtuar me kujdes të gjithë elementët (kalimet këmbësore, këndet e shikimit, ndriçimi, etj.).

c. Siguria dhe sinjalistika rrugore

Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale dhe horizontale për t'i dhënë përdoruesve të rrugës informacionin e duhur për të qarkulluar në mënyrë të sigurt dhe të ligjshme.

Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë speciale bikomponente. Sinjalistika vertikale duhet të pasurohet me të gjitha tabelat e nevojshme (orientimi, lartësia, pozicionimi dhe përmasat e tabelave të sinjalistikës vertikale jepen në Rregulloren e Kodit Rrugor të Shqipërisë (RrKRrSh).

Në territore me ndërtime, tabelat duhet të vendosen më lart. Kur ato ngrihen në trotuare apo ku ka lëvizje këmbësorësh, duhet të lejojnë një qartësi të mjaftueshme për këmbësorët: preferohet 230 cm dhe 220 cm si minimum. Pranë kryqëzimeve të vendosen sinjalistika vertikale për secilën rrugë apo degëzim sipas senseve të orientimit përkatës.

Llojet e sinjaleve rrugore, vertikale dhe horizontale, të vlefshme për përdorim, jepen në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë (Korrik 1998) dhe "Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor Shqiptar" (Prill 2001).

Duhet patur parasysh të gjithë elementët e sigurisë rrugore, ku, sinjalistika është vetëm një komponent i saj. Të merren në konsideratë problemet e mundshme të sigurisë në lidhje me përdoruesit e rrugës, sipas kategorive, ku, hyjnë në mënyrë të përgjithshme elementët për mjetet (dukshmëria, hyrje- daljet dhe tipi i tyre, parakalimi, gjerësia e korsive për qarkullim të përzier të mjeteve, pikave të konfliktit në një kryqëzim, etj.) e deri te këmbësorët në mjaftueshmërinë e pikave të kalimit të këmbësorëve dhe krijimin e rampave.

Dhe së fundmi në funksion të planeve të qarkullimit, vendoset sinjalistika përkatëse, e cila përfshin atë vertikale, horizontale dhe semaforike. Hartimi i projekteve për zbatim të sinjalizimit rrugor të jetë sipas planeve urbane me synim standartizimin e kushteve të qarkullimit dhe sigurisë rrugore, në përputhje me rregullat urbanistike dhe me planin e transportit të jetë sipas planeve urbane me synim standartizimin e kushteve të qarkullimit dhe sigurisë rrugore, në përputhje me rregullat urbanistike dhe me planin e transportit.

Të trajtohet në projekt mënyra e lëvizjes si dhe masat e sigurisë së këmbësorëve dhe banorëve të zonës gjatë punës për realizimin e objektit në të gjitha fazat. Projektuesi duhet të paraqesë në

fletë të veçanta të gjitha detajet e nevojshme të masave të sigurisë që do të reflektohen edhe në preventiv. Skema e rrjetit rrugor dhe plani i propozuar i ndërhyrjes për lirim të sheshit të ndërtimit (prishjet) do të diskutohen me Bashkinë dhe pasi të marrë miratimin e saj, projektuesi vazhdon me detajimin në projekt-zbatimi të projektit.

d. Ndriçimi rrugor dhe dekorativ

Ndriçimi rrugor duhet të parashikohet të bëhet i ri.

Në rrugë me gjerësi deri në 9 m të parashikohet vendosja në njërin krah e shtyllave të reja metalike me lartësi $H = 7.8$ m dhe me spesor $\delta = 4$ mm.

Kokat e ndriçuesave do jenë me gradë të lartë rezistence dhe me reflektor alumini me luçidim të lartë i paoksidueshëm, i cili bën në një masë shumë të lartë pasqyrimin e dritës. Hapja dhe mbyllja e xhamit të ndriçuesit lejon një çmontim të shpejtë gjatë mirëmbajtjes. Llambat e ndriçimit do të jenë LED me fuqi 150 wat deri 250 wat.

Të respektohen normat Europiane të performancës së ndriçimit EN 13201 :

Ndriçuesit të jenë me kontroll smart në mënyrë, që të rregullohet intensiteti i ndriçimit sipas orëve dhe fluksit të përdorimit të rrugës.

Përzgjedhja e normës së ndriçimit sipas PD CEN/TR 13201-1:2014. Të përcaktohet performanca e ndriçimit sipas përdoruesve të rrugës (makina, biçikleta, këmbësor).

Të përcaktohen indikatorët e performancës së energjisë:

1. Treguesi i densitetit të fuqisë metrike (PDI) DP (i matur në $w/(lx \cdot m^2)$ dhe
2. Treguesi vjetor të konsumit të energjisë (AECDI) DE (të matur në $(wh)/m^2$).

Të përcaktohet lloji i rrugës sipas standartit EN 13201 Urbane, Rurale, Parësore, Dytësore, në mënyrë, që të përcaktohet edhe lloji dhe intensiteti i ndriçimit. Jetëgjatësia e ndriçuesit LED sipas standartit IEC 62722-2-1.

Të përcaktohet temperatura e ndriçimit sipas standartit nga 2500 deri 5000 Kelvin, në mënyrë, që të evitohet efekti i ndotjes.

Të përcaktohen termat e sigurisë, mbrojtja nga tensioni, nga lagështia, etj.

Linja të jetë me trasë nëntokësore, ku të vendoset tub plastik fleksibël me dy shtresa me $d=90$ mm për kalimin e kablrit të furnizimit dhe tub metalik me $d=110$ mm për intersektim rruge.

Pusetat të jenë prej betoni me përmasa brenda përbrenda $40 \times 40 \times 40$ cm me kapak gize. Distanca ndërmjet pusetave të jetë 25 m larg njëra tjetrës dhe të vendosen mbrapa çdo shtylle për tu mbrojtur nga dëmtimet e mundshme. Panelet e komandimit të vendosen me komandim sauteri me fotoelementë.

Të parashikohet dalje energjie në puseta të veçanta për zonat e gjelbëra.

Furnizimi me energji i rrjetit të ndriçimit do të bëhet nga kabinat ekzistuese të zonës. Në këto kabina do të instalohen panelet e ndriçimit rrugor, të cilat do të ushqehen me ura të veçanta nga transformatori ekzistues. Në kabinë do parashikohet dhe vendosja e matësve të energjisë. Do të parashikohet tokëzimi i shtyllave të ndriçimit.

Të parashikohet dhe skema e furnizimit me energji elektrike për ndriçimin rrugor.

e. Kanalizimet e ujërave të zeza dhe ujërave të shiut

Qyteti i Himarës dhe konkretisht fshati Borsh kohët e fundit ka pësuar ndryshime të dukshme në drejtim të shtrirjes së ndërtimeve duke ndjekur dy drejtime kryesore, të cilat në funksion të zhvillimit të tyre kanë sjellë probleme në rrjetin e kanalizimeve. Si drejtim i parë është rritja e intensitetit të ndërtimeve në zonat ekzistuese të ndërtimit dhe drejtimi i dytë është zhvillimi i ndërtimeve në zona pothuajse të pazhvilluara më parë. Të dy rastet sjellin, si rezultat rritjen e sasive të ujërave të zeza dhe ujërave të shiut, respektivisht për shkak të rritjes së konsumit të ujit në zonë dhe rritjes së rrjedhës së ujërave të shiut.

Të nisur nga sa më sipër gjatë hartimit të projekt-zbatimit duhen parashikuar:

1. Të merret në konsideratë perspektiva 20 vjeçare e rritjes së popullsisë;
2. Të merret në konsideratë ruajtja e rrjetit ekzistues nëse ka kapacitetin e mjaftueshëm përçjellës dhe është në gjendje të mirë punë. Informacion më i detajuar duhet të merret pranë ujësjellës-kanalizime Himarë (ish "ujësjellsi Himarë"), SHRUK-së dhe AKUK së.
3. Drejtimi i zhvillimit urbanistik të zonës, të merret parasysh zhvillimi në perspektivë i zonës referuar Planit të Përgjithshëm Vendor.
4. Të merret në konsideratë "Studimi i Planit të zhvillimit të sistemit të kanalizimeve" të kryer nga kompani konsulente (nëse ka).

Sistemi i largimit të ujërave të bardha dhe të zeza të jetë i ndarë.

Sasitë e ujit, që derdhen në sistemin e kanalizimeve. Për sasitë e ujërave të zeza, që derdhen në sistemin e kanalizimeve rekomandohet të përdoren normat dhe kushtet teknike të projektimit.

Për sasitë e ujërave të shiut do të përdoren të dhënat e Institutit Hidrometeorologjik dhe mënyra e llogaritjes do të paraqitet nga projektuesi në mënyrë të argumentuar.

Siguria llogaritëse. Siguria llogaritëse e ujërave të shiut do të llogaritet 25 % për kolektorët kryesorë dhe 40 % për kolektorët sekondarë.

Vlera e llogaritjes së shiut të merret për periudhë përsëritje 1 herë në vit dhe kohëzgjatje prej 15 minutash.

Materiali kryesor ndërtimor, për kanalizimin do të jetë përdorimi i tubave prej polietileni të brinjëzuar të llogaritura për të përballuar ngarkesat ose tubacione betoni me gota, pusetat dhe nënobjektet e tjera do të jenë me material betoni të armuar duke eliminuar përdorimin e materialit të tullës në sistemin e kanalizimeve, që ka rezultuar me probleme. Megjithatë projektuesi do të argumentojë materialet që do të përdoren për çdo nën objekt. Pusetat duhet të jenë të pajisura me shkallë metalike.

Për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të shiut do të përdoren *puseta betoni me zgarë me kapak*

me material kompozit.

f. Ujësjellësi

Në bashkëpunim me ujësjellës-kanalizime Himarë (ish "ujësjellsi Himarë") do të saktësohet dhe gjendja e ujësjellësit ekzistues, projektet, që ka kjo ndërmarje, si dhe problemet e vërejtura në këtë zonë gjatë periudhës së furnizimit me ujë me rrjetin ekzistues të ujësjellësit. Norma e furnizimit e rekomanduar do të jetë 150 l/ditë/banor. Materialet, që do të përdoren për tubacionet e ujësjellësit do të jenë tuba polietileni HDPE- 100 për 10 atm, që plotësojnë normativat në fuqi, kanë përbërjen kimike dhe aftësinë mbajtëse ndaj presioneve të llogaritura. E njëjta gjë vlen edhe për pajisjet hidraulike dhe aksesorët.

Saraçineskat dhe pajisjet e tjera hidraulike, që do të përdoren duhet të jenë $P_n=16$ atm. Për nyjet do të parashikohen puseta me kapak b/a, përmasat e të cilave duhet të realizohen sipas kushteve teknike dhe të sigurojnë kushte normale manovrimi dhe riparimi. Pusetat duhet të jenë të pajisura me shkallë metalike në rastet kur janë të thella. Për lidhjet e banesave me tubacione me diametër më të vogël se 2" sugjerohet të përdoren puseta komandimi me aks vertikal.

Të parashikohen nga projektuesi, në bashkëpunim me ujësjellës-kanalizime Himarë, vendi i kasetave për sahatët e matjes së ujit.

g. Hidrantët zjarrfikës

Gjatë fazës së hartimit të projektit projektuesi duhet të parashikojë vendosjen e hidrantëve zjarrfikës, referuar normave të miratuara në fuqi dhe rregullores së PMNZSH-së.

h. Elementët urban

Një vëmendje të veçantë në projekt, projektuesi duhet t'i kushtojë edhe elementëve të mobilimit urban (ose kur është rasti edhe të artit urban) që do të propozojë të përdoren përgjatë të gjithë pedonale, si: stola, kosha të mbeturinave, vendin e vendosjes së konteinerëve dhe të largimit publik të mbeturinave (përcaktimi i tyre të bëhet në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në Bashki), zgara apo rrethime të pemëve, kangjella kufizuese në trotuare (kur është rasti) si dhe bllokues të mjeteve në trotuare, zgarat për biçikletat, etj. Koshat për hedhjen e mbeturinave duhet të jenë të komandueshme për tu pastruar lehtësisht nga shoqëritë përkatëse të pastrimit, dhe kjo duhet të specifikohet në projekt në detajin përkatës.

Të verifikohen dhe të parashikohen lidhja e ullukëve të shkarkimit të tarracave me pusetat K.U.SH. të rrugëve, duke parashikuar punime për t'i kaluar nën nivelin e trotuareve të rrugës dhe lidhjen e tyre deri në pusetën K.U.SH. më të afërt.

Detaje teknike të ndryshme për ndërhyrjet, që do të propozohen.

Projektuesi duhet të trajtojë këto elementë në fazën e projektit të zbatimit (me të dhëna të plota për furnizim-vendosje), ku të përcaktojë detaje tip, frekuencën e vendosjes, pra skemën e shpërndarjes së tyre, llojin e materialit, detaje të inkastrimit, ngjyrat, sasinë, zërin në preventiv etj.

h.1 Krijimi i nyjeve rekreative dhe të shërbimit përgjatë shëtitorës

Duke marrë në konsideratë gjatësinë e konsiderueshme të shëtitorës bregdetare, rreth 5 km, projektuesi duhet të studiojë krijimin e një sistemi të shpërndarë të **nyjeve rekreative, të qëndrimit dhe të shërbimit**, me qëllim gjallërimin e të gjithë itinerarit dhe krijimin e pikave tërheqëse përgjatë vijës bregdetare.

Në mënyrë orientuese, të studiohet krijimi i **nyjeve të aktivitetit në intervale mesatare rreth 500 m**, duke përshtatur pozicionimin përfundimtar me kushtet konkrete të territorit, gjerësinë e shëtitorës, aksesin, gjendjen pronësore, flukset e lëvizjes dhe karakteristikat natyrore të vijës bregdetare.

Në këto nyje mund të parashikohen **struktura shërbimi të tipit beach bar/kafe bregdetare**, të integruara me hapësirë qëndrimi, zona të hijëzuara, mobilim urban dhe elemente rekreative. Strukturat duhet të konceptohen me **arkitekturë bashkëkohore, të lehtë dhe të integruar me peizazhin bregdetar**, me përdorim të drurit, gurit natyror të zonës, të integruara me hapësirë qëndrimi, zona të hijëzuara, mobilim urban dhe elemente rekreative dhe materialeve rezistente ndaj kushteve detare. Strukturat duhet të konceptohen kryesisht me materiale druri, me arkitekturë bashkëkohore, të lehtë dhe të integruar me peizazhin bregdetar. Druri duhet të jetë i trajtuar për kushtet e mjedisit detar, ndërsa guri natyror i zonës mund të përdoret për bazamente, shtrime dhe elemente mbështetëse/dekorative."

Projektuesi duhet të hartojë një **tipologji arkitektonike të unifikuar dhe identitare për këto struktura**, në mënyrë që beach bar-et dhe pikat e shërbimit të perceptohen si pjesë e së njëjtës gjuhë arkitektonike të Shëtitorës së Borshit. Mund të propozohen variante të së njëjtës tipologji bazë, duke ndryshuar konfigurimin dhe përmasat në varësi të segmentit ku vendosen.

Çdo nyje duhet të trajtohet si një **mikroshesh publik bregdetar**, ku funksioni i shërbimit integrohet me hapësirën publike dhe nuk pengon vazhdimësinë e korridorit të lirë këmbësor, korsinë e biçikletave apo aksesin drejt plazhit.

Në fazën e projekt-idesë, projektuesi duhet të paraqesë një **skemë të plotë të shpërndarjes së nyjeve përgjatë gjithë gjatësisë së shëtitorës**, duke argumentuar distancat, pozicionet dhe funksionin e secilës prej tyre. Numri dhe pozicionimi përfundimtar i strukturave të shërbimit do të përcaktohen mbi bazën e analizës teknike dhe territoriale dhe do t'i nënshtrohen miratimit të Autoritetit Kontraktor.

Disa mund të jenë **beach bar modern**, disa **kafe/pikë panoramike**, ndërsa të tjera mund të kombinohen me **kënd lojërash, teatër të hapur ose shesh aktivitetesh**. Kështu shëtitorja krijon një **ritëm urban përgjatë 5 km** dhe nuk bëhet monotone.

Profili i zgjeruar dhe dimensionet (orientuese)



h.2 Trajtimi i ujërave të zeza për beach bar-et dhe strukturat e shërbimit

Për çdo strukturë shërbimi të tipit beach bar/kafe bregdetare, projektuesi duhet të parashikojë zgjidhjen e plotë për mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat mjedisore në fuqi.

Në rastet kur zona nuk mbulohet nga rrjeti publik i kanalizimeve, ose kur lidhja me rrjetin ekzistues nuk është teknikisht e mundur, projektuesi duhet të studiojë dhe të propozojë **impiant individual ose të grupuar për trajtimin e ujërave të zeza**, të dimensionuar sipas kapacitetit të secilës strukturë shërbimi dhe fluksit sezonal të përdorimit.

Impiantet e trajtimit duhet të jenë të integruara në mënyrë diskrete në projekt, pa cenuar peizazhin bregdetar, përdorimin publik të shëtitorës dhe cilësinë e plazhit. Vendndodhja, kapaciteti, teknologjia, mënyra e mirëmbajtjes dhe shkarkimi përfundimtar duhet të argumentohen nga projektuesi dhe të koordinohen me institucionet përgjegjëse.

Nuk lejohet shkarkimi i drejtpërdrejtë i ujërave të zeza në plazh, në det, në përrenj apo në rrjetin e ujërave të bardha. Çdo zgjidhje duhet të garantojë mbrojtjen e mjedisit, higjienën publike dhe funksionimin e qëndrueshëm të strukturave të shërbimit gjatë gjithë sezonit turistik.

h.3 Furnizimi me energji elektrike dhe ujë për strukturat e shërbimit

Për çdo strukturë shërbimi të tipit beach bar/kafe bregdetare, si dhe për çdo nyje rekreative përgjatë shëtitorës, projektuesi duhet të parashikojë **pikat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm**, të dimensionuara sipas kapacitetit dhe funksionit të secilës strukturë.

Projektuesi duhet të studiojë lidhjen me rrjetet ekzistuese të zonës dhe, në bashkëpunim me institucionet/ndërmarrjet përgjegjëse, të përcaktojë:

- pikën e furnizimit me energji elektrike;
- pikën e furnizimit me ujë;
- trasenë e lidhjeve teknike;
- pusetat/kuadrot/nyjet e kontrollit;
- matësit përkatës;
- kapacitetin e kërkuar për çdo strukturë;
- masat mbrojtëse dhe sigurinë teknike të instalimeve.

Furnizimi me energji elektrike duhet të realizohet nëpërmjet rrjetit nëntokësor, me kuadro të veçanta, matje të dedikuara dhe elemente mbrojtëse sipas normave në fuqi. Për çdo beach bar apo pikë shërbimi duhet të parashikohet kapaciteti i nevojshëm për ndriçim, pajisje shërbimi, sisteme ftohjeje/ngrohjeje, pompa, pajisje teknologjike dhe nevoja të tjera funksionale.

Furnizimi me ujë duhet të parashikohet me lidhje të kontrolluar në rrjetin ekzistues ose në zgjidhje alternative të miratuara, duke garantuar presionin, sasinë dhe cilësinë e nevojshme për funksionimin higjieno-sanitar të strukturave.

Në projekt duhet të paraqitet **skema e plotë e furnizimit me energji elektrike dhe ujë për të gjitha strukturat e shërbimit**, përfshirë planvendosjen e pikave të lidhjes, detajet teknike, kapacitetet, preventivin dhe grafikun e zbatimit.

l. Rrjeti Internet-Telefonisë

Të ndërtohet rrjeti i tubacioneve shpërndarëse të internet – telefonisë, sipas standarteve të përcaktuara duke marrë në konsideratë numrin e operatorëve operues në zonë, numrin e

komunitetit përfitues, si dhe zhvillimin në prespektivë të këtij shërbimi, për një periudhë kohore 10 vjeçare. Ky rrjet duhet të shtrihet në të gjithë akset rrugore kryesore dhe sekondare si dhe të ketë ndërlidhje me rrjetin ekzistues në zonat kufizuese rreth bllokut (ajror ose nëntokësore).

Duhet të respektohet standarti i rregullores Nr. 22 AKEP, mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kablore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike.

J. Gjelbërimi

Të parashikohet vendosja e gjelbërimit të lartë (pemëve dekorative) në trotuar, vetëm në rastet kur gjerësia e trotuarit të jetë më e madhe se 2 m.

K. Korsitë e bicikletave

Duhet të merret parasysh plani i detyruar i zonës për ndërtimin e korsive të biçikletave në akset rrugore.

L. Korsitë dhe stacionet e autobusit

Gjatë fazës së hartimit të projektit në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Himarë, të parashikohen korsitë e dedikuara me sinjalistikën përkatëse dhe xhepa për stacionet e linjave të autobuzëve të linjave urbane.

4. Fazat e zbatimit

Për efekt të fondit të zbatimit, të realizimit të prishjeve (të mundshme) si dhe të efijencës së ndërhyrjes, projektuesi duhet t'i rekomandojë investitorit fazat e realizimit në kohë (ose sipas elementëve të ndryshëm) të projektit.

Projektuesi mund t'i rekomandojë Investitorit, që projekti të realizohet në disa faza ose lote, si dhe sipas elementëve të ndryshëm të tij (psh. rrjetit rrugor dhe infrastruktura/punime ndërtimi, apo mobilimi urban/furnizim, vendosje).

Lidhur me këtë fakt, projektuesi do të propozojë fazat e realizimit të projektit, ku të dhënat (si fletët e projektit, preventiva, grafiku i punimeve) për çdo fazë duhet të jenë të konceptuara ose të organizuara, që të lehtësojnë Investitorin në organizimin e zbatimit (buxhetim, prokurim, kontraktim për zbatim) të projektit me faza.

5. Standardet

a. Standarde në projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim, që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elementë të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe limitimet për financimin e veprës.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për PAK (personat me aftësi të kufizuara). Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori. Detajet teknike të infrastrukturës për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të projektit.

b. Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të parashikohet dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji "Për urbanistikën". Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

6. Realizimi i projektit

Realizimi i projektit do të mbështetet në fazat e VKM Nr. 354, datë 11.05.2016, Neni 42, Neni 43.

FAZA I Analiza e detyrës së projektimit

Analiza e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit (format A4); Vëzhgimi dhe mbledhja e dokumenteve kartografike për zonën në të cilën duhet ndërhyrë - (formati A3/A2).

Materiale grafike të përgatitura nga konsulenti duhet të përfshijë:

- Pozicionimi në hartat;
- Foto e situatës ekzistuese;
- Vrojtimi gjeometrik dhe arkitektonik i situatës ekzistuese;
- Kryqëzimet;
- Përshkrimi i situatës aktuale;
- Verifikimi i projekteve të miratuara për zonën objekt studimi etj.

Fletët grafike do të përgatiten bazuar në vrojtimin; ato duhet të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme.

Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy (të printuar) dhe 1 cd në format soft copy (cad, excel, word).

FAZA II Projekt ide paraprake (Përgatitja e projektit dhe planifikimit).

Përpunimi pjesëve të rëndësishme të një zgjidhjeje të detyrës së planifikimit, e cila do paraqitet në jo më pak se 2 variant-propozime, ku për secilin variant do dorëzohet:

- a. Analiza e aksesibilitetit dhe zonimit, referuar Planit të PDV-s
- b. Vlerësimi i ndërtimeve ekzistuese (evidentimi i objekteve që prishen/ruhen)

- c. Vizatimet teknike, planimetri të përgjithshme, prerje tip të rrugëve, në një shkallë të lexueshme;
- d. Analiza dhe propozimi për qarkullimin e automjeteve dhe vendet e parkimit; konceptet e transportit
- e. Relacion teknik (mbi ndërhyrjet e parashikuara);
- f. Preventiv paraprak.

Varianti me treguesit më social - ekonomik dhe teknik, që do të përzgjidhet nga Këshilli Teknik (Stafi teknik në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhhvillimit të Territorit pranë Autoritetit), do të vazhdojë procedurën e hartimit të projekt-idesë përfundimtare.

(Të paraqiten variantet e propozuar me preventivat paraprake e specifikimet përkatëse duke përfshirë dhe kostot e shpronësimeve, nëse ka, për secilin variant).

Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy (të printuar) dhe 1 cd në format soft copy (cad, excel, word).

FAZA III Projekt ide përfundimtare (planifikimi i sistemit dhe i integritit)

Përpunimi i zgjidhjes përfundimtare të detyrës së planifikimit.

Në këtë fazë konsulenti duhet të përgatisë projekt idenë përfundimtare të ndërhyrjeve, pas miratimit në Këshill Teknik të variantit socio-ekonomik dhe teknik më të përshtatshëm të miratuar në fazën e projekt idesë-paraprake, e cila duhet të përmbajë:

- a. Raport teknik;
- b. Preventivin e punimeve, referuar VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve";
- c. Analizat teknike të çmimeve, për zërat, që nuk ndodhen në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve";
- d. Vizatimet teknike për të gjitha punimet e parashikuara me detajet përkatëse;
- e. Specifikimet teknike për zërat e punimeve, që do të kryhen;
- f. Grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të punës;
- g. Rilevimi;
- h. Studimi gjeologjik.

Materialet dorëzohen në 1 kopje format hard copy (të printuar) dhe 1 cd në format soft copy (cad, excel, word).

Pranë Drejtorive përkatëse të Bashkisë dhe institucioneve në varësi, kryhet aplikimi, nga ana e operatorit ekonomik të kontraktuar për hartimin e studim-projektimit, për vendosjen në dispozicion të informacionit në lidhje me azhornimet inxhinierike, statusin juridik të pronës, etj.

FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit: Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore.

Projektuesi gjithashtu duhet të parashikojë dhe projektin për miratimin e lejes së ndërtimit, i cili duhet të mbështetet në ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit". Për këtë për çdo dokumentacion të nevojshëm për hartimin e projektit si dhe për aplikimin për leje ndërtimi përmes portalit të Regjistrimit të Integruar të Territorit, të bashkëpunohet me Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Himarë.

Materialet dorëzohen në 2 kopje cd, projekti dhe dokumentacioni shoqëruar me vulë elektronike.

FAZA V: Projekti zbatimit: Përpunimi dhe paraqitja e planit të zgjidhjes së gatshme për zbatim.

Dosja e plotë e projektit të zbatimit për objektin: "**NDËRTIMI I PEDONALES SË BORSHIT**" duhet të përmbajë:

1. Raporti teknik;
- Raporti përfundimtar teknik përfshin të gjitha informacionet në lidhje me projektin, duke shpjeguar arsyet në të cilat u bazua skema e detajuar e projektit. Ai përshkruan analizën e bërë nga projektuesi për situatën dhe projektin e propozuar. Raporti të sigurojë të dhëna të sakta, bazuar në testet/vlerësimet ekzistuese, llogaritjet e bëra, llogaritja e shtresave rrugore, ndriçimit, etj., masat inxhinierike që parashikohen të merren, etj. Në raportin teknik do të përfshihet raport arkitektonik, raport strukturor, elektrik, hidro, etj., si dhe studimet mbështetëse (vlerësimet topografike, gjeologjik dhe materiale, raport hidrologjik dhe hidraulik, etj.).
- Llogaritjet statike të strukturave (në rast kur kemi parashikuar mure mbajtëse);
- Llogaritjet e shtresave, të dhëna të sakta bazuar në teste për gjendjen ekzistuese, masat inxhinierike, që janë parashikuar të merren, siguria e kalimit në rrugë dhe masat që duhet të merren për rregullimin e trafikut gjatë punimeve të ndërtimit dhe specifikimet teknike për çdo zë pune.
- Metoda e llogaritjes së shtresave të jetë e bazuar në CBR
2. Hartimi i relievit topografik të bllokut (koordinata lokale, kuota absolute);
3. Pasqyrimi në projekt i azhornimeve të rrjetit ekzistues të ujësjellësit, rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut dhe të zeza, rrjetit të elektrikut dhe internet – telefonisë;
4. Raport gjeologjik;
5. Analizë e situatës ekzistuese dhe të prishjeve të ndërtimeve pa leje (nëse ka);
6. Tabela volumetrike e prishjeve;
7. Planimetrinë dhe raportin e shpronësimeve
- Planet e shpronësimit duhet të përfshijnë planin e zonave kadastrale dhe sipërfaqeve përkatëse, të konfirmuara nga ZRPP.
8. Skemën e qarkullimit në rrugë.
9. Projektin e zbatimit të trasesë së projektit;
10. Kuotat e pushtave ekzistuese (koka e tubit, diametri i tubit);
11. Profilin gjatësor të rrugëve;

12. Profilat tërthorë të rrugëve;
 13. Profilat tip të seksionit tërthor të rrugëve;
 14. Detajet e ndryshme të trotuarit, bordurave, etj;
 15. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut;
 16. Studimi hidrologjik për të përcaktuar hidromodulin e zonës në studim;
 17. Analizat dhe llogaritjet e rreshjeve në zonë;
 18. Llogaritjet e shkarkimit maksimal të ujërave.
 19. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza;
 20. Projektin e zbatimit të rrjetit të ujësjellësit përfshirë dhe detajet e pusetave të pajisjeve dhe rakorderive të nyjeve, etj;
 21. Projektin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, në vendosjen e hidrantëve zjarrfikës mbështetur në normat në fuqi;
 22. Projektin dhe planet e ndriçimit rrugor dhe dekorativ;
 23. Skema e furnizimit me energji elektrike dhe detajet përkatëse;
 24. Llogaritja dhe skema e paneleve elektrike;
 25. Projektin e zbatimit për ndërtimin e rrjetit të linjave rezervë;
 26. Sinjalistikën rrugore horizontale dhe vertikale dhe parkimet;
 27. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
 - Kontraktuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilën material që do të përdoret.
- Për secilën punë të përfshirë në preventiv, duhet të bëhet analiza sipas kësaj skeme:
- Përshkrimi i detajuar i procesit të punës;
 - Metoda e vendosjes;
 - Cilësia e kërkuar;
 - Format e miratuara;
 - Ngjyra e rekomanduar;
 - Skica, vizatime ose foto
 28. Preventivin e punimeve mbështetur në manualin teknik të çmimeve në fuqi;
 29. Grafikun e punimeve të ndërtimit;
 30. Plan organizimin e punimeve dhe ngritjen e kantierit në funksion të mjeteve, që do të jenë pjesë e realizimit të objektit, mbështetur dhe në grafikun e punimeve;
 31. Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM);
 32. Liçensë të firmës projektuese, liçensë të ekspertit mjedisor dhe ekstrakt i regjistrimit tregtar.
 33. Deklaratat e përgjegjësisë profesionale të firmës projektuese dhe stafit;

Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy (të printuar) dhe 5 cd (4 cd në format soft copy cad, excel, word, etj dhe 1 cd në format pdf).

FAZA VI: Hartimi i preventivit përfundimtar

Për hartimin e preventivit projektuesi duhet të mbështetet në VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve". Për secilin zë punimi, i cili nuk është i përfshirë në këtë

manual, projektuesi duhet të dorëzojë analizat/ofertat përkatëse të çmimeve.

Në hartimin e preventivit, veç të tjerave do të mbahen parasysh sa më lart, lidhur me organizmin e zbatimit me faza, çmimet e referencës sipas akteve ligjore në fuqi, dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve.

Preventivi do të hartohet sipas formatit/modelit standart të VKM nr. 216, datë 13.04.2023.

7. Rekomandime për projektuesin

a) Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me rrugën. Projektuesi duhet të hartojë, përveç projektit përfundimtar dhe një projekt teknik i cili duhet të analizojë rast pas rasti të gjitha prishjet e mundshme për të realizuar me faza këte investim.

b) Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake, që disponohen nga Bashkia e Himarës, seksioni i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe nga Kadastra. Në hartimin e projektit duhet të merren në konsideratë edhe standarte të ndryshme, që ka nxjerrë Bashkia e Himarës, siç janë p.sh. tipi i kollonave të ndriçimit, llojet e ndriçuesve e të tjera të kësaj natyre.

c) Grupi i projektimit përveç rrjetit rrugor dhe të infrastrukturës nëntokësore, duhet të trajtojë dhe hapësirat e brendshme të bllokut, si zonat e gjelbërta, terrenet sportive, këndet e lojërave për fëmijë etj.

d) Në projekt të parashikohet mundësia e krijimit të faciliteteteve për PAK.

8. Paraqitja e vizatimeve

Vizatimet e projektit duhet të përmbajnë minimalisht fletët si mëposhtë:

- Horografia
- Topografinë e gjendjes ekzistuese, në të cilën të jenë të azhuruara të gjitha ndërtimet në gjendjen e sotme (me leje dhe pa leje) në Shk. 1:500 ose 1:1000;
- Planimetria e sistemit të pedonales/rrugës në Shk. 1:500 ose 1:1000;
- Planimetria e prishjeve në shkallë 1:500;
- Profilet gjatësorë të rrugëve Shk. 1:1000, 1:100;
- Profilet tërthorë të rrugëve jo më pak se 25 m;
- Detaje konstruktive tip të shtresave të rrugës, trotuarëve, pusetave, etj.;
- Kryqëzimet dhe detaje përkatëse;
- Planimetria e rrjetit të kanalizimeve në shkallën 1: 500;
- Profilet gjatësorë të rrjetit të kanalizimeve në Shk. H1:1000,V1:100;
- Pusetat dhe detaje të tjera të rrjetit të kanalizimeve;
- Planimetria e rrjetit të ujësjellësit në shkallën 1: 500;
- Profilet gjatësorë të rrjetit të ujësjellësit në Shk. H1:1000,V1:100;
- Pusetat, detajet e nyjeve dhe lidhjeve si dhe detaje të tjera të rrjetit të ujësjellësit;
- Planimetri dhe detaje për lëvizshmëri/sinjalistikën rrugore;
- Planimetria e hapësirave publike dhe mobilimit urban;

- Detaje teknike të mobilimit urban;
- Planimetria e ndriçimit rrugor dhe detaje të ndriçimit rrugor;
- Planimetria e tubacioneve të rrjetit të internet telefonisë në shkallë 1:500;
- Profilët gjatësore të rrjetit të internet telefonisë në Sh: H 1:1000, V 1:500;
- Detaje të mënyrës së vendosjes së PVC, të rrjetit të internet telefonisë dhe intersektimit me rrugët SH 1:25;

Të gjitha fletët e vizatimeve duhet të jenë të detajuara me elementët përkatës, si dhe legjendat përkatëse.

9. Planimetria e shpronësimeve

Kjo planimetri do të identifikojë pronat dhe godinat, që preken nga realizimi i projektit shoqëruar me llogaritjen e sipërfaqes, që preket për arsye shpronësimi.

10. Raportimi dhe dorëzimi final

Dorëzimi final, fizik, i projektit të zbatimit, do të konsiderohet ai, i cili do të ketë kaluar njëherë të gjitha fazat e mësipërme dhe projekti do t'i nënshtrohet opinionit teknik të Institutit të Ndërtimit.

Në afatet e dorëzimit përfshihet dhe koha 1 javore për komentet e klientit për secilën fazë.

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë projektuesit.

Materialet dorëzohen në 3 kopje format hard copy (të printuar) dhe 3 cd (3 cd në format soft copy cad, excel, word edhe në format pdf)

Gjithashtu do dorëzohet versioni i dixhitalizuar i cili transferohet në GIS.


11. Investimi Themelor

Investimi themelor do të dalë nga varianti më i mirë i asistuar dhe nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

12. Sqarime të fundit

Projektuesi është përgjegjës të sigurojë saktësinë dhe pajtueshmërinë me të gjitha standardet dhe normat përkatëse.

Të dhënat e nevojshme për projektim, sikurse janë: gjendja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të kanalizimeve, ndriçimit, kabinat e tensionit të lartë, vendosja e kontenierëve, planin rregullues të zonës, etj, do të merren nga projektuesi sipas formularëve përkatës.



Grupi i punës

Ing. Klodi Ajazaj

Ark. Elvira Marko

Ing. Anida Xhani

Ing. Igli Çuka